

	KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
---	---	---

PROCESVERBAL

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 8 (tetë) të rregullt për vitin 2026,të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë

Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës

Data: 29.07.2026

Ora: 10:00

Prezentë në takim:

Znj. Sanie Kuçi
Rexhepaj

Z. Flamur Bytyçi

Znj. Doruntina Zenelaj

Z. Urim Suka

Z. Astrit Salihu

Z. Nexhat Ramadani

Znj. Vlorë Kryeziu

Znj. Dafina Kolgeci

Z. Bexhet Kuçi

Znj.Albulena Kokollari

Z. Edon Sadikaj

Z. Aziz Bytyçi

Znj. Mimoza Bajraktari

Z. Enver Shabani

Znj. Besa Kuçi

Z. Syl Zenelaj

Z. Ilir Voci

Z. Dardan Berisha

Z. Labinot Halitjaha

Znj. Merita Basha

Z. Demokrat Vataj

Znj.Afërdita Morina

Znj. Antigona Zyba

Z. Liridon Fandaj

Z. Qëndrim Elshani

Znj. Laureta Tafaj

Znj. Jehona Rrafshi

Lumi

Të pranishëm tjerë:

Kryetari i Komunës

Media dhe qytetarë

OSCE, LMT, KDI

Znj.Habibe Bytyqi

Z.Xheladin Sadika

Takimin e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z.Bexhet Kuçi,i cili i njoftoi me rendin e ditës.

REND DITE

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për këmbimin e pronës komunale me pronën private;
3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-9877;
4. Rishqyrtimi i vendimit 01-Nr-020-24518 për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave të fshatrave;
5. Shqyrtimi i projekt-vendimit paraprak për të zhvilluar procedurat përmes konkurrit të hapur për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës;
6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit monitorues i zbatimit të PZHK-së dhe Hartës Zonale të Komunës së Suhatekës;
7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit për vitin 2025 të komisionit komunal të aksionarëve të NPL „Eko Theranda“ SH.A. ;
8. Informatë për administrimin e buxhetit të komunës së Suharekës për periudhën janar-qershor 2026;
9. Informatë për aktivitetet e KKSb-së për periudhën janar-qershor 2026;
10. Raporti i Drejtorisë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër për menaxhimin e pronave për periudhën janar-qershor 2026;
11. Pyetje dhe përgjigje;

Flamur Bytyçi - kam një kërkesë për propozim si pikë shtesë e cila ka të bëjë për vendosjen e pllakatës së komandant Shaban Gashit në fshatin Savrovë.Kërkoj prej kolegëve dhe juve mbështetje dhe kjo të jetë si pikë e katër në rend dite.

Kryesuesi - e kuptoj që çdo asambleist ka të drejtë me propozu pika të rendit të ditës por për pikën që po e kërkon ju me fut në rend dite,e kam njohur edhe unë personalisht Shaban Gashin,kemi pas mardhënie të mira dhe kemi qenë ushtar bashkë.Ne kemi edhe shumë kërkesa tjera dhe për me vendos një pllakatë në një lokacion të caktuar,këtu mund të na ndihmoj edhe zyrtari ligjor por sa e di unë pllakat vendosen edhe pa pëlqimin e Asamblesë.Me nda një lokacion për me vendos një pllakë është Drejtoria e Kadastrës.

Flamur Bytyçi - kjo nuk ka të bëjë vetëm me vendosjen e pllakatës por duhet edhe si institucion m'u kujdes që me u bë pllakata.Kjo kërkesë nuk është vetëm kërkesë e imja individuale por është kërkesë e veteranëve të fshatit Savrovë dhe e Kryetarit të fshatit.Kërkesën mund t'ua dërgoj secilit prej jush.

Kryesuesi - zakonisht kërkesa të tilla mund të vijnë përmes shoqatës së veteranëve të luftës.Unë jam për me mbështet mirëpo unë po kërkoj me shku në mënyrë institucionale,me nda lokacionin nëse duhet ose për me vendos një pllakë mundet edhe me një kërkesë te Urbanizmi dhe ia jep një pëlqim.

Dardan Berisha - nuk është logjike kjo me që ne nuk e kemi dokumentin para vetes.Nuk e kemi parcelën dhe as ku ka me u vendos. A do të futete si pikë e rendit të ditës me u diskutu apo si?Ne jemi të paqartë dhe po biem në lajthitje.Para një muaji shoqatat e dalura nga lufta i kanë vendos mbi 5 pllaka nëpër lokacione të ndryshme.Unë mendoj që këtu një kontribut të madh duhet me dhënë ai që po kërkon me vendos përmes Drejtorisë së Pronës,me vendos lokacionin.Ne nuk jemi kundër tyre sepse ne e dimë që kur po vjen 13 Qershori,ne po ndajmë mirënjohje dhe nganjëherë po dalim edhe jashtë rregullores për mos me i hy në hak askujt.Kjo është pak e ndieshme por paraprakisht ne duhet me qenë më të përgaditur çka po votojmë.Mendoj që kjo pikë të trajtohet mirë dhe të vje si pikë e rregullt dhe ne jemi pro.

Flamur Bytyçi - realisht po mundohet me marrë kahje tjetër kjo çështje.Në këtë dokument është numri i parcelës i cili është nxjerr në kataster dhe secili prej jush jeni të njoftuar këtu për këtë rast.E imja është me vendos në votim dhe e juaja është e votoni,s'e votoni.

Aziz Bytyqi - respekt për personalitetin që propozohet dhe poashtu edhe për propozuesin por unë mendoj që kjo kërkesë mundet me shku me një procedurë të rregullt pasi nuk është urgjente,çoftë përmes Drejtorisë së Urbanizmit ose përmes kuvendit ku adresohet përmes KPF-së.Nuk di nëse kemi marrë një vendim për rastet e ngjajshme.Ne jemi për dhe e mirëkuptojmë por pse mos ta ndjekim një procedurë të rregullt.Unë jam i informuar dhe e kam informuar grupin por e kemi diskutu paraprakisht që kjo të shkoj përmes Drejtorisë së Urbanizmit.

Kryesuesi - e heh në votim pikën shtesë për rend dite.

12 për,11 kundër,3 apstenime,Miratohet pika shtesë

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës me pikën shtesë.

17 për,2 kundër,2 apstenime,Miratohet rendi i ditës

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet pika 1

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për këmbimin e pronës komunale me pronën private;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - sa i përket këtij projekt-vendimi dallimi në mes pronës private dhe pronës komunale është rreth 1.650,00€.Çka do të ndodh me pjesën e mbetur pasi që prona komunale është me vlerë më të lartë se sa prona private? Te dokumentacioni i vendimit është një vendim me datë 29.10.2024 që kjo pronë është shpall për interes të përgjithshëm me 55 m² ndërsa me 28.03.2025 është 122 m².Cila është arsyeja që ne i kemi dy vendime dhe me cilën m'u bazu dhe pse ka ndryshu kjo pjesë?Te destinimi,parcela e komunës ka destinim banim me shumë njesi afarizmi ndërsa privatja është banim me shumë njesi të afarizmit dhe pjesërisht infrastrukturë.A ka ndryshim tjetër?Po ashtu avokati i komunës thotë që prona komunale nuk e ka asnjë kontest gjyqësor ndërsa nuk ka njohuri për pronën private.Çka ndodh nëse ne e kalojmë këtë pjesë dhe prona private ka kontest gjyqësor për deri sa nuk kemi ne informata?Ne e mbështesim dhe duhet m'u rregullu si infrastrukturë por nuk e mbështesim që prona komunale m'u dëmtu nëse vlera e pronës komunale është më e madhe. Me këto dokumentacione ne jemi kundër këtij vendimi.

Sanie Kuçi Rexhepaj - kjo pikë si dokumentacion në fillim po krijon një farë konfuziteti në atë çka po kërkon DSHPJK dhe në atë çka projekt-vendimi po përmban për shkak se kërkesa e drejtorisë është për këmbim të 55 m² të pronës komunale me 55 m² të pronës private por kur e lexon projekt-vendimin kërkohe këmbimi pronës 139m² pronë publike me 177m² pronë private.Ne i kemi marrë dy vendime mandatin e kaluar për shpallje të interesit të përgjithshëm dhe njëra prej vendimeve përfshin edhe një pjesë tjetër të parcelës e që është edhe prona tjetër private me nr.kadastral 2816-12 ku atëherë është shpall interes i përgjithshëm por në këtë rast pjesë e këmbimit më nuk është.Çka do të ndodh me këtë parcelë?a do të lirohet nga intersi i përgjithshëm apo mbetet në këtë formë për shkak se e bllokun procesin e pastrimit të këtij blloku ndërtimor?Një pyetje për Drejtorin e Urbanizmit të cilit ia kam bërë pyetjen në KPF dhe më është përgjigj por dua të njejtën përgjigje me ma dhënë këtu për transparencë.Ky bllok ndërtimor i cili përbëhte prej disa parcelave,nga rruga kryesore një pjesë rrugës Brigada 123 është në pronësi të ministrisë dhe prek në këtë bllok ndërtimor.A krijon pengesë në urbanizëm për dhënien e lejes ndërtimore kjo pjesë e parcelës e cila është e bllokut ndërtimor që me destinim është ndërtim me shumë njesi?

Armend Krasniqi - realisht këtu janë nisur dy procedura fillimisht.Një është nis 55 me 55 m² ku vlerësimi ka qenë 220 me 250 në favor të pronarëve ndërsa procedura e dytë 12284 m² ku vlerësimi ka qenë në favor të komunës.Pasi bëhet fjalë për rregullimin e të njejtit bllok ndërtues në vlerësimin e dytë të inicimit të këmbimit të dytë,3.890€ komuna i ka borgj atyre në dy procedurat.Pasi bëhet fjalë për të njejtin pronar unë mendoj që nuk paraqet problem ligjor.Siç e di pronarët e këtyre parcelave kanë shprehur dëshirë që 8,390.00€ t'ia falin komunës.

Visar Kuçi - sa i përket pyetjes së Liridonit,si destinim në HZK është ZHSHP5 të gjitha parcelat kurse sa i përket pyetjes së Sanies,bëhet fjalë për parcelën e cila prek në rrugën Brigada 123.Ajo parcelë është pjesë e ministrisë dhe është fakt që prek në bllokun ndërtimor të kësaj parcelle dhe është një sipërfaqe më pak se 50m² dhe intresi i komunës është me u zgjeru infrastruktura dhe nuk kemi pengesa ligjore apo teknike.

Kryesuesi - sa e di unë keni pas një takim me personat në fjalë dhe kanë thënë që heqin dorë.

Visar Kuçi - unë kam qenë në takim por nuk u kyqa në këtë temë për shkak se është kompetencë e drejtorive tjera dhe iu përgjigja vetëm pjesës së urbanizmit.

Liridon Fandaj - Armend a e di për cilin vendim jemi duke vendosur tash?

Armend Krasniqi - tani jemi duke vendos për 122m² me 84m².Vlerësimi është 26,840.00 është për Sevdije Berisha ndërsa për komunën është 16,800.00€.

Liridon Fandaj - as prona komunale dhe as prona private nuk konpenzohet si po thua ti. Pa pas një dokument të bashkangjitur që edhe ai është deklaruar që heq dorë prej atij kompenzimi, unë mendoj që ky vendim nuk bën me kalu.

Armend Krasniqi - jep sqarime edhe njëherë sa i përket vendimit.

Liridon Fandaj - a ka vendim të noterizuar që ai ka heq dorë prej atij kompenzimi siq po thua ti?

Armend Krasniqi - ne e kemi parapa HZK-në dhe e kemi obligim me rregullu ashtu siq e kemi parapa. Ne e kemi nis një procedurë që vet e kemi parapa. Ministria e ka vlerësuar më shumë pronën private se pronën komunale dhe komuna është e obliguar që ti paguaj 8,390.00€ te pronarët privat mirëpo ata janë të pajtimit që këto para mos me i marrë vetëm që ta bëjmë zgjidhjen për me nis bllokun ndërtimor dhe komuna të zgjidh problemin që vet e ka për obligim me zgjidh.

Kryetari - Liridon nuk është rasti i parë. Kemi pas rast te rruga Luigj Nikolla ku pronari ka qenë nga Semetishti dhe vlera ka qenë 6,000.00€ me ia dhënë komuna atij. Ka shku te noteri, ka nënshkru dhe ia ka bërë falje komunës. Komuna nuk paguan para, komuna mundet vetëm me kompenzu, me dhënë dhe me marrë.

Liridon Fandaj - nëse sot nuk e kemi deklaratën që ai heq dorë, ky vendim nuk bën me kalu.

Kryetari - leja e ndërtimit nuk i lëshohet. Nuk i duhen atij 55m² tokë. Ky vendim shkon ma tutje edhe në ministri për ligjshmëri.

Nexhat Ramadani - unë e kam të qartë kërkesën e Liridonit dhe është e arsyeshme. Ne nuk mund të marrim vendim nëse të gjitha çështjet nuk janë të sqaruara. Çështja e lejes nuk është procedurë e jona sepse kur ta marrim këtë vendim përgjegjësia për leje është te ata.

Armend Krasniqi - drejtori jep sqarime.

Nexhat Ramadani - ti nëse e ke rregullu atë, duhet me pas dokument para se me marrë ne vendimin sepse siq tha edhe Liridoni nëse ajo ndërron mendjen dhe thotë që nuk ka marrëveshje me komunën.

Kryesuesi - le ta jep një sqarim zyrtari ligjor mirëpo duhet ta dimë që këtu po e fillojmë bazën e pastaj vjen ajo a heq dorë apo jo, është çështje e tij.

Avni Bytyqi - zyrtari ligjor jep sqarime dhe thotë: nëse i referohemi projekt-vendimit konkretisht nenit 4 e specifikon qartë: pas këmbimit të pronave publike me pronën private, Kryetari i komunës është i obliguar të nënshkruaj kontratë me këmbyesit me qëllim të bartjes së pronave në librat kadastrale. Kryetari i komunës pas miratimit nga ky kuvend dhe konfirmimit të ligjshmërisë nga ministria e linjes, ka për obligim të nënshkruaj kontratë për bartjen e pronave. Para se ta nënshkruaj kontratën Kryetari i komunës ka për obligim të kompenzoj vlerën financiare që është më e madhe se sa prona publike, ose të merret vesh me palët me qëllim që ata të heqin dorë nga mjetet financiare nëse pajtohen. Ne nuk mundemi me i fut në obligime palët para se ky vendim të miratohet në kuvend dhe para se ky vendim të merr konfirmimin e ligjshmërisë nga ministria sepse Kryetari nuk guxon ti shkel vendimet e kuvendit nëse thuhet këtu që ka me nënshkru kontratë dhe e ka obligim me nënshkru kontratë për bartjen e pronave.

Urim Suka - shumica e gjërave u qartësuan me këtë çka tha Avniu. Unë çuditë se pse Drejtori i Bujqësisë përgjigjet për një çështje kur kjo ka të bëjë me Drejtorinë e Katastrës. Në parim ne jemi për me u kry këto për shkak se edhe HZK-ja e parasheh dhe me i dhënë rrugë zhvillimit atje.

Sanie Kuçi Rexhepaj - ne e kemi shpall interes të përgjithshëm edhe një pjesë tjetër të një parcele tjetër ku pronar është dikush tjetër dhe pyeta se çka po ndodh me atë parcelë. A lirohet nga interesi i përgjithshëm dhe me çfarë vendimi lirohet nga interesi i përgjithshëm nëse vazhdon të jetë interes i përgjithshëm edhe ajo pjesë e parcelës? Pjesa e parcelës është 2816-12,27m² nga 149m² të asaj pjese ku pronarë janë B Famis dhe Etika shpk nga Suhareka dhe qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm është rregullimi i infrastrukturës në rrugën Luigj Nikolla.

Avni Bytyqi - inicimi i procedurës për shpallje interes i përgjithshëm është inicuar për dy parcela siq i përmende Drejtori mirëpo kur i ka dërgu Drejtorinë e Pronës për vlerësim të pronës, ka dërgu pronë publike pak në krahasim me atë se çka është shpall interes të përgjithshëm dhe nuk ka mundur ta mbërrij metrin katror për me mbulu sipërfaqen që ka kërkuar në bazë të vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm. Atëherë komuna këtë parcelë prej 27m² nuk e ka inicuar për këmbim për arsye se nuk ka pronë për të cilën ka mendu për me këmbu dhe janë dakordu që prona prej 27m² nëse nuk është pengesë në rregullimin e infrastrukturës në rrugën „Luigj Nikolla“, atëherë vjen vendimi dhe shfuqizohet vendimi për shpalljen interes i përgjithshëm. Nëse është pengesë në rregullimin e infrastrukturës rrugore në rrugën „Luigj Nikolla“, Komuna ka për obligim të fillon procedurën e këmbimit dhe të dërgoj në ministri përsëri vlerësimin e pronës të kësaj parcele.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-9877;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - sa here ne vim këtu për me marrë vendime,gjithmonë duhet ta kemi seriozitetin për secilin vendim.Ajo që po ndodh është se ju nuk e keni këtë seriozitet kur i trajtoni këto vendime dhe ne po vazhdojmë gati në çdo seancë me shfuqizu vendime për shkak të kësaj situatë.Siç e ka konstatu edhe ministria,nuk janë në harmoni listat e pronave kur i publikoni për ti dhënë në shfrytëzim me vendimet që i marrim.Në listen e pronave keni parapa që këtë pronë me dhënë në shfrytëzim afatgjatë 15 deri 99 vite por kur e kemi marrë vendimin,e keni bërë për ta dhënë në shfrytëzim afatshkurtë deri 15 vite.Ne kërkojmë që secilin vendim ta trajtoni me seriozitetin maksimal me idenë që me i zvogëlu këto shfuqizime të panevojshme.Normal që ne si grup do ta shfuqizojmë sepse në fakt edhe atëherë kemi qenë kundër,kemi kërku sqarime dhe s'kanë qenë këtu me na dhënë sqarimet e nevojshme.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

Unanimisht Miratohet pika 3

Pika 4. Rishqyrtimi i vendimit 01-Nr-020-24518 për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave të fshatrave;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Nexhat Ramadani - kjo tash po rregullohet por komisioni i formuar herën e kaluar ka mbajt një takim ku na ka ftu drejtori. Ju sugjeroj që paraprakisht neve si anëtar të komisionit me na sjell rregulloren ose një vendim se cilat janë përgjegjësitë tona.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

Unanimisht Miratohet pika 4

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit paraprak për të zhvilluar procedurat përmes konkurrit të hapur për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Astrit Salihu - nëse ka mundësi drejtori ta bëj një elaborom më të detajuar për këtë pikë. A ka të interesuar? A është një investitor apo ka më shumë investitorë dhe si do të vijojë procedura?

Mensur Selimaj - një kërkesë ka ardhë prej një biznesi. Në moment që ka një kërkesë,ne i drejtohem Kryetarit dhe Kryetari ju drejtohet juve.

Avni Bytyqi - ky është vendim paraprak për të cilën kuvendi e lejon komunën që të zhvillojë procedurat e konkurimit të hapur me qëllim që të ketë konkurenca për marrjen e pronave publike ne shfrytezim. Formohet komisioni nga ky kuvend dhe komisioni ka për obligim të shpall thirrjen publike. Të interesuarit mund të aplikojnë dhe nuk e dime sa mund të aplikojnë.

Urim Suka - në parim kur e sheh një projekt-vendim të tillë duket një ide e mirë. Kërkoj pak sqarime në aspektin mjedisor, në aspektin e banorëve,në aspektin e fshatit se a do të ketë problem.Ju e keni parapa 17 vite por kur është 17 vite ndoshta është më mire me lënë 15 vite me procedure afatshkurtër dhe si procedure më lehtë me u kry.

Mensur Selimaj - ne kemi shku për shkak të kërkesave të llojllojshme të bizneseve, qytetarëve,të investitorëve të jashtëm.Ne jemi detyru me vendos afatgjatë sepse është investim i madh për këdo që e merr pronën.Drejtori tutje jep sqarime.

Urim Suka - unë mendoj që komuna për secilën parcellë që e ka në pronësi duhet me ditë gjithmonë interesin e vet se a duhet me dhënë afatshkurt apo afatgjatë dhe kur ti bën listat që i publikon një vit përpara për pronat që ka me i dhënë në shfrytëzim duhet me qenë e specifikuar për 15 ose për 99 vite.

Visar Kuçi - sa i përket pjesës së ndikimit në mjedis,nëse merret në shfrytëzim prona për këtë veprimtari,me leje ndërtimore i pajis ministria por edhe nëse i ndjek te komuna,procedurat kanë me u ndjek dhe pa leje mjedisore nuk e lëshojmë.Urimi pati një pyetje se pse nuk e keni 15 vite me procedure më të thjeshtë se 17 vite.Dhënia e pronave publike janë afatshkurtër 1 deri 15 vite, afatmesëm deri në 35 vite dhe afatgjatë 99 vite.

Avni Bytyqi - iniciimi i procedurës ka qenë për 15 vite. Kur e kemi shiku listen e pronave kjo pronë ka qenë 15 deri 99 vite dhe për mos me zgjat këtë çështje deri në vitin e ardhshëm, e kemi inicuar me 17 vite. Nuk do të thotë pse ky e merr në shfrytëzim e realizon projektin. Rreth 25 kërkesa ka me i pas në ministri për m'u pais me leje, me licencë etj. Por hapi i parë i operatorit është me pas pronën se ku do ti vendos panelat diellor.

Urim Suka - unë e pata të qartë atë që tha Avniu por përgjigja e drejtorit ishte tjetër kah. Andaj kur ti bëni këto lista, shumë komuna i diskutojnë, i votojnë në kuvend dhe i publikojnë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

Unanimisht Miratohet pika 5

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit monitorues i zbatimit të PZHK-së dhe Hartës Zonale të Komunës së Suhatekës;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Sanie Kuçi Rexhepaj - në fakt mire do të ishte siç propozoj Urimi më herët dhe ka propozu disa here të tjera që secila pike e rendit të ditës m'u parapri me prezantim ose sqarim paraprak nga secili drejtor që e ka sjell këtë pike të rendit të ditës. Si pasojë e mosraportimit në suaza vjetore ne kemi has në pengesa si komunë ku s'mund pa përmend rregulloren e bonus zonimit në vitin e kaluar që me vendim të ministrisë ne si kuvend e shfuqizuam ku njëra prej arsyeve ka qenë si pasojë e mosraportimit të PZHK-së dhe HZK-së. Komuna e Suhatekës në vitin 2021 e ka miratu një dokument planifikues PZHK 2021-2029 e që në përmbajtje planifikon zhvillimin strategjik të komunës për 8 vitet e ardhshme në secilën fushë. Pas miratimit të këtij plani komuna në bazë të ligjit për planifikim hapësinor ka pas për obligim që në suaza vjetore me raportu rreth zbatimit të këtij plani. Çdo dokument tjetër që është hartu pas PZHK-së, bazën kryesore është dasht me pas në këtë dokument. Në vitin 2022 kuvendi ka miratu Hartën Zonale të komunës 2022-2030 e në përmbajtje HZK ka definu kushtet ndërtimore për shfrytëzimin dhe vëllimin e tokës. Edhe për këtë dokument komuna ka pas obligim që të raportojë në suaza vjetore rreth zbatimit të HZK-së dhe deri më sot asnjë raportim. Në vitin 2026 tash po na vjen një raport i përmbledhur i zbatimit të PZHK-së dhe HZK-së 2023-2024 dhe 2025. Si asambleiste edhe këtë mandat por edhe mandatin e kaluar kam qenë ndër më të zëshmet dhe kam kërku që ky raport me u sjell. Sa i përket diskutimit të sotëm, mire që ka ardhë raporti por ky raport ka shumë mangësi. Fillimisht po mungon raportimi i PZHK-së për vitin 2022. Në KPF drejtori tha nuk kemi raportu për PZHK-në pasi PZHK nuk ka pas zbatim në vitin 2022. Edhe mandatin e kaluar por edhe në KPF i potencova drejtorit që edhe nëse s'ka pas PZHK zbatim në vitin 2022, të paktën një paragraf është dasht me cek që në vitin 2022 PZHK nuk ka gjet zbatim për x arsyet. Kur e kontrollova raportin e pashë që PZHK kish pas zbatim në një pikë. Një prej prioriteteve strategjike e ke pas hartimin e HZK dhe pikërisht në vitin 2022 HZK u miratu. PZHK dhe HZK nuk janë një dokument dhe neve na ka ardhë një raport për të dyjat njëkohësisht. Janë dy dokumente të ndara, të hartuara veqmas, të miratuara në periudha të ndryshme kohore dhe me përmbajtje të ndryshme. Për këtë arsye ne si grup konsiderojmë që raportimi duhet të sillet në dokumente të ndara. Përfshirja e të dy dokumenteve në një raport të vetëm e vështirëson analizën e progresit të secilit dokument, krijon paqartësi në vlerësimin e indikatorëve specifik dhe nuk mundëson që kuvendi të diskutoj veqmas realizimin e objektivave strategjike të PZHK-së dhe veqmas zbatimin e dispozitave të HZK-së. Gjithëashtu nga përmbajtja e raportit krijohet përshtypja që po raportohet vetëm për HZK-në. Në përgjithësi raporti është shumë narrativ, jep vlerësime të larta pa u bazu në fakte të realizimit. Ndoshta kjo për arsye se një pjesë e ekipit kanë qenë drejtorë të pozitës politike dhe jo zyrtarë komunal. Për pasoj raporti jep përshtypjen e një vetvlerësimi të punës së ekzekutivit në vend se të jetë një monitorim objektiv dhe kritik i zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor. Në faqe 4 të këtij raporti tabela e numrit të lejeve ndërtimore në dy raste listohet certifikata e përdorimit me parametra të ndryshëm për vitet e njejtë. Ndoshta është gabim teknik por që po krijon konfuzion. Në faqe 6 thotë që DUPM ka ofruar mundësinë e marrjes së informatave për destinimet e planifikuara si dhe çasjen në përdorimin e sistemit E-leja. A funksionon kjo çasje? Sepse ka kohë që unë e provoj çasjen në link por nuk ka informacion. Nëse nuk funksionon se di pse e keni raportu. Në faqe 9 te shkalla e ngritjes së cilësisë së shërbimeve publike dhe sociale thuhet: vlen të ceket në bashkëpunim me donatorët është ndërtuar një qendër e specializuar për fëmijë me autizëm dhe objekti i ri i Hendikosit. Këto objekte nuk janë të ndërtuara me bashkëpunim por janë tërësisht të ndërtuara nga donatorët. Qendra Duje ka disa mbledhje radhazi ku është temë diskutimi në Asamble që po funksionon ajo organizatë pa licence

përkatese ku Liridoni e ka ngrit disa here këtë çështje dhe mirë është me u raportu në formën e duhur. Te pjesa e projekteve strategjike, fillimisht një kritikë teknike. Keni raportu veqmas për 2023, veqmas për 2024 dhe veqmas për 2025 por keni mundur të njejtën tabelë vetëm të krijoni dhe tri kolona të reja dhe për 2023 me cek a është zbatu ai proces apo jo. Te kolona e sqarimeve shtesë për secilin vit na keni kriju 29 faqe me tabelat e njejtë. Te pjesa e projekteve strategjike po mungon raportimi. Janë mbi 30 prioritetet strategjike që nuk keni raportu. Furnizimi me material fidanor mjedër -dredhës, nuk keni raportu. Rregullimi dhe ndërtimi i shtallave për bagëti. Hapja e dy puseve -projekt i furnizimeve me ujë në Agrozonë. Hartimi i planit rregullues të hollësishëm të fshatit turistik rekreativ në Delloc. Hartimi i planit rregullues të hollësishëm të fshatit agroturistik. Ndërtimi i ujësjellësit në Duhël. Ndërtimi i ujësjellësit në Javor. Lidhja e Vraniqit, Popolanit, Savrovës dhe Sopisë përmes tubacionit kryesor në burimin e Vraniqit. Furnizimi i vendbanimeve Bukosh2: Maqiteva, Delloci, Mushtishti, Dvorani dhe Dubrava nga burimi i Dellocit si dhe disa burime të marra nga gryka e Maqitevës. Furnizimi i qytetit të Suharekës si dhe fshatrat: Budakovë, Buzhalë, Bukosh1, Krushicë dhe Reqan nga rrjedhjet e ujit në fshatin Budakovë dhe gryka e Buzhalës që ka sasi të konsiderueshme të ujit 25 deri 35 litra në sekond. Për këto projekte nuk keni raportu por ka edhe shumë të tjera. Po ashtu në disa projekte që janë të listuara por nuk janë realizu, mungon përshkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve pse nuk janë realizu. Në disa projekte thuhet që janë realizu por mungon specifikimi i përqindjes të të dhënave të tjera. Meremetimi dhe ndërtimi i kanalizimeve thuhet në tabelë që është realizu 100%. Krejt komuna është e mbuluar me sistemin e kanalizimit a! Zbatimi i planit të veprimit të planit të mobilitetit thotë që 100% është i realizuar. Një plan që është për periudhën 2024-2034 nuk mund të plotësohet 100% për shkak se është në fuqi deri në vitin 2034 dhe ka ende kohë për me u realizu. Nuk është e mundur 100% e një plani me u realizu. Ndërtimi i sistemit smart city për rritjen e sigurisë në komunikacion, shkruhet që është e realizuar 100%. Renovimi i shtëpisë së kultures në Mushtisht thotë që 100% është e realizuar. Nuk është bërë renovimi i shtëpisë së kultures në Mushtisht por është ndërtu objekti rishtas dhe kjo duhet të specifikohet dhe të tregohet se pse ky projekt ka ndryshu. Krijimi i rrjetit të organizatave kulturore thotë 100%. Aktivitetet e edukimit joformal mbështeten përmes subvencioneve. Mbështetja përmes subvencioneve nuk do të thotë që po krijohet një rrjet i organizatave kulturore. Krijimi i rrjetit është komplet çështje tjetër dhe subvencionimi është çështje tjetër. Hartimi i planit rregullues të hollësishëm zona qendër. Thuhet jo për shkak të një gabimi teknik në PZHK, në HZK ku te harta e planeve rregulluese nuk janë vendosur ato të planifikuara por ekzistuese. Nëse është gabim teknik dhe nëse kishit raportu në suaza vjetore drejtor, shumë lehtë kuvendi e kish marrë një vendim për përmirësimin e gabimeve teknike. Pse i njejtë gabim teknik nuk ju paska pengu në hartimin e planit rregullues në zonën ekonomike në Duhël, në Shirokë dhe në Delloc? Ne kemi prit gjatë për me ardhë ky raportim dhe e shohim të arsyeshme si grup që me prit edhe një muaj më shumë që të gjitha këto me u përmirësu dhe me u raportu edhe për të gjitha projektet që nuk është raportu. Të sillen raportet e ndara, për PZHK-në veqmas për periudhën 2022-2023-2024-2025 dhe për HZK-në veqmas për periudhën 203-2024-2025.

Visar Kuçi - është fakt që vendimi i PZHK-së është lëshuar në vitin 2017 dhe në fund të vitit 2021 është miratu dhe ka hy në fuqi. Nuk është zbatu në aspektin për shkak se buxheti ka kalu më herët. Jo vetëm HZK-ja por ka edhe projekte të tjera që kanë qenë me PZHK-në por buxheti ka hy më herët. Kur ka hy HZK-ja në fuqi unë s'kam pas vendim të ekipit të PZHK-së. Tabela ku ti i përmende projektet, kjo është edhe te PZHK dhe te monitorimi i HZK-së. Në tabelë është shumë e qartë dhe e saktë qysh m'u raportu. Këto janë projektet që kanë pas me u realizu në periudhën e PZHK-së. Është bartë edhe te HZK-ja. Në tabelë e kemi pas titullin e projektit, realizimi i projektit. Ti ke qenë vet në ekip në PZHK dhe ju në PZHK i keni fut një projekt ndoshta për shkak të mungesës së buxhetit ose thithjes së fondeve, e keni fut në 2022, 2023, 2024 dhe nëse nuk është realizu në '22, e ke bërë që nuk është realizuar dhe nëse u realizu në '23 e ke bërë po sepse u realizu në atë vit. Sa i përket kanalizimeve apo smart, është bërë 100% për atë vit sepse buxheti që është parapa u realizu. Te HZK-ja, HZK përbëhet prej tri dokumenteve, njëra është dokumentet e pjesës së hartës, pjesa grafike dhe pjesa tekstuale, është edhe shtojca për monitorimin dhe zbatimin e dokumentit. I gjithë raporti është punu në bazë të shtojcës që e ka HZK-ja për monitorimin e dokumentit. Secila pjesë e ekipit e ka zbatu, i ka marrë projektet në përqindje sa janë realizu. Në pjesën e fundit e ke se cila drejtori ka pas me zbatu këtë projekt apo cila njesi. Ka shumë projekte që i ka pas edhe ministria ose ndërmarrjet publike. Ne i kemi shiku projektet që janë propozu dhe cilat janë realizu. Sa i përket tabelës faqe 4 te lejet ndërtimore nuk është gabim teknik. Drejtori jep sqarime. Te pjesa e lejës, leja është duke funksionu shumë mire por ndoshta ka qenë në prove linku, hartuesi i dokumentit që e ka pun. Shumë kush edhe ka gabu dhe nëse ekziston i bëj kërkesë me heq atë link me

Insi.info.Sot ne e kemi linkun e veçantë që e kemi marrë prej ASHI-së dhe është duke funksionu por here pas here ndoshta edhe bie nga sistemi.Sa i përket planit rregullues të hollësishëm në zonën qendër,mandatin e kaluar e kam sjellë.Te pjesa grafike e HZK-së janë afërsisht 11 harta dhe njëra prej hartave janë edhe planet rregulluese të cilat planifikohen me u hartu.Është bërë një gabim që nuk na ka kthyer ministria përgjigje.Jam konsultu me ministrinë dhe duhet të bëhet një raport i veçantë ku duhet me përfshi zonën qendër.Si arsye ne e kemi dhënë për shkak të një gabimi që u përsërit dhe nuk kemi mujt ta realizojmë por duhet të realizohet sepse zona qendër është e ndieshme dhe kemi nevojë.Ato që janë realizu edhe janë raportu në përqindjen që janë realizu.E gjithë kjo tabelë ka qenë e gatshme nga PZHK-ja dhe HZK-ja,plane që kanë pas me u realizu për periudhë dhe ne vetëm kemi pas me plotësu.Ka projekte edhe jasht PZHK-së dhe HZK-së që janë kryer që ne nuk i kemi raportu sepse janë tepër.

Sanie Kuçi - mos jep sqarime rreth formës tabelare sepse vet e the kam qenë pjesë e ekipit dhe e di mire si është procesi.Unë po them që në PZHK dhe HZK janë dy forma tabelare të prioriteteve strategjike dhe nuk po përkojnë me tabelat që ju na keni sjell në këtë raport.Mungojnë projekte që janë të parapara në PZHK dhe HZK.Njëra prej pikave është hartimi i planit të mobilitetit të cilën e kemi miratu në kuvend dhe nuk ke raportu në këtë raport që është miratu por vetëm ke thënë që është zbatu.Nuk përmendet as zgjerimi i stacionit komunal të autobusëve.

Visar Kuçi - ti e ke dokumentin dhe shikoji sepse janë. Është stacioni i autobusëve në PZHK dhe HZK.
Sanie Kuçi Rexhepaj - drejtor gjeje te forma tabelare raportin që na ke sjell ku është miratimi i HZK-së.Janë mbi 30 projekte strategjike që janë të parapara në PZHK dhe HZK që po mungojnë te pjesa e raportimit tuaj.Te pjesa e çertifikatave,aty po shkruan qertifikatë e përdorimit,nuk po shkruan leje ndërtimore.Leja ndërtimore nuk është qertifikatë e përdorimit.Nëse don me nda,e ndan në kategori si leje ndërtimore të kategorisë së parë janë kaq dhe leje ndërtimore të kategorisë së dytë janë kaq.Vet po thua çertifikatë e përdorimit dhe po thua zero. Zero dhe 14 kanë dallim dhe bëhet fjalë për të njejtin vit. E ke sjell dy herë zonën qendër në kuvend por nuk t'ka konvenu vija territoriale e zones qendër.Ke tentu me tejkalu vijën dhe për atë arsye nuk ka hec përpara zona qendër.

Visar Kuçi - të jap përgjigje me fakte asamblenë e ardhme edhe për këtë.Ky dokument ka rrjedh prej planit të monitorimit.Nuk pajtohem nëse nuk është konform me PZHK-në dhe HZK-në.Vet ke marrë pjesë në PZHK dhe ke fillu HZK-në.E kemi një dokument ku është i specifikuar dhe shkruan shtojca numër 2.Na kanë obligu dokumenti që është miratu në këtë asamble që ne me plotësu përmes shtojcës 2 nga plani i monitorimit.Ne për raportin tjetër kur të vjen nëse nuk është në harmoni ky dokument te shtojca me HZK-në dhe PZHK-në,ne duhet me i paraqit si projekte që janë bërë lëshime ose nuk janë sipas tabelave të PZHK-së dhe HZK-së konform me tabelat e planit të monitorimit.Nëse ka ndonjë projekt që nuk është përmend këtu e atje është përmend,mund ta përmirësojmë në raportin tjetër.

Laureta Tafaj - sa i përket kësaj pike unë në KPF drejtorit të Urbanizmit i kam dhënë disa rekomandime. Ndoshta ka qenë koha e shkurtë por nuk kam marrë asnjë pohim për to. Kemi prit kohë të gjatë për me ardhë ky raport dhe do të presim deri sa edhe rekomandimet tona të përfshihen në këtë raport e pastaj do të flasim për votën pro ose kundër.

Urim Suka - s'kam çka shtoj asgjë më shumë për atë që tha Sania sepse është eksperte e fushës në këtë drejtim dhe pajtohem me çdo çështje që ka ngrit ajo.Sot na ka ardhë raporti por unë sot i kam 5 vite në asamble dhe për here të pare ka ardhë një raport i tillë dhe kjo më shqetëson shumë sepse ligji e specifikon që çdo vit duhet me raportu për këto çështje.Sikur ne këto raporte ti kishim në baza vjetore siq e thotë ligji,besoj edhe problemet kishin me qenë më të vogla.Ju si pushtet nuk keni pas gadishmëri me raportu dhe me zbatu ligjin deri më tash.Mirë që ka ardhë ky raport dhe ne me seriozitetin më të madh e kemi trajtu në detaje këtë çështje dhe kur e kemi trajtu e kemi pa që ky raport edhe pse ka ardhë me vonesë,është jashtëzakonisht i mangët dhe në kundërshtim edhe me ato që duhet me raportu.Ne si grup parlamentar përkundër që do t'kishim pas dëshirë me dhënë votën për për këtë raport,ne nuk mundemi me u bërë pjesë e një raporti i cili ka shumë mangësi andaj i bëjmë thirrje drejtorit që pas kësaj që ka ardhë,të raportohet në vazhdimësi sipas ligjit.E votojmë kundër.

Flamur Bytyçi - e kam diskutu në KPF këtë raport dhe është mire që ka ardhë edhe pse me vonesë.Njëra prej sqarimeve që e ka dhënë drejtorja ose komisioni ka qenë për shkak të angazhimeve të mëdhaja sektoriale.Drejtorja juaj ka punuar punë tjera e realisht nuk e ka pas këtë si pike më të rëndësishme e cila i hap rrugë vendimit propozimit që e keni sjell për bonus ndërtim.Në njërën prej arsytiveve që e ka dhënë ministria ka qenë pikërisht mungesa e raportit.A beson drejtor që ky raport ka me kalu në ministri?Nëse s'kalon çka doni me i thënë ju atyre bizneseve të cilat presin me kalu bonus ndërtimi?

Visar Kuçi - nuk e di a kalon apo s'kalon.Mirë është me kalu por edhe nëse nuk kalon,na japin vërejtjet,i përmirësojmë dhe kalojmë në fazën tjetër.Ju lus edhe juve ta kaloni sot këtë raport.Edhe nëse kthehet,i

përmirësojmë. Sa për informacion në ministri është vetëm një raport prej të gjitha komunave. Komuna e Lipjanit e ka deri tash vetëm raportin e 2024 dhe ne e kemi marrë si mostër.

Flamur Bytyçi - ne e kemi kundërshtu pikërisht për këtë çështje dhe ju e keni dit mire që pa u kry ky raport, bonus ndërtimi nuk kalon.

Visar Kuçi - është fakt që ministria e ka shkru në fund që një prej arsyeve është edhe raporti por raporti me bonusin nuk e lidh. Ne e marrim ligjin dhe kemi me fillu edhe bonus zonimin, kemi me ju thirr edhe në shqyrtime, kemi me punu. Është një problem tjetër te rregullorja e bonuseve por ne do të punojmë deri në fund.

Sanie Kuçi Rexhepaj - raporti është mire me u votu pro por ne kemi kërku që me u nda veqmas dhe po mungon raportimi i PZHK-së për vitin 2022. Në KPF unë e kam mbështet si pikë për me ardhë në asamble por në mungesë të raportimit të shumë prioritetëve strategjike, ne si grup nuk e votojmë miratimin e këtij raporti. Besoj ka me pas here tjetër dhe nëse vjen raporti në formë të ndarë dhe për seciln vit përkatës dhe me të gjitha prioritet strategjike që i ka PZHK-ja dhe HZK-ja, atëherë po.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 6.

14 për, 13 kundër, Miratohet pika 6

Pika 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit për vitin 2025 të komisionit komunal të aksionarëve të NPL „Eko Theranda“ SH.A. ;

Kryesuesi - meqenëse kryesuesi është pjesë e komisionit komunal të aksionarëve i cili është i përbërë prej tre anëtarëve, Kryesuesi raporton në pika të gjëra rreth themelimit, problemeve në fillimet e ndërmarrjes, punëve, shërbimeve e stafit të kësaj ndërmarrje.

Dafina Kolgeci - faleminderit kryesues për raportin që e lexuat por mirë do të ishte që ne këtë raport me pas paraprakisht për asamble. Ne e mirëpresim funksionalizimin dhe krijimin e ndërmarrjes Ekotheranda. Duke qenë se bëhet fjalë për një ndërmarrje të themeluar në vitin e kaluar, ne e kuptojmë që kjo është një periudhë e fokusuar në konsolidim, ngritjen e kapaciteteve dhe organizimin e punës. Për momentin kjo ndërmarrje financohet nga buxheti i komunës por nga ana financiare, a mendoni që në të ardhmen me pas inkasim dhe të hyra që kjo me u pavarësu prej buxhetit të komunës? Gjithëashtu në raport te pjesa e menaxhimit financiar keni shkruar që nuk janë realizuar shpenzime reprezentative ndërsa në tabelë shkruan që ka shpenzime reprezentative reprezentacion prej 188.40 cent, a është gabim?

Kryesuesi - nuk është gabim, është një vlerë shumë minimale sepse ka qenë fillimi i ndërmarrjes. Para jush paraqita historikun dhe procesin financiar të shpenzimit por shpresoj që në të ardhmen kjo ndërmarrje ta ketë edhe inkasimin e vet personal.

Liridon Fandaj - për ndërmarrjen kisha dhënë disa rekomandime që në të ardhmen me pas parasysh për shkak që me këtë trend që është ndërmarrja, të gjitha mjetet financiare janë veq për paga dhe për kontribute. Nuk ka të hyra vetanake për me zhvillu ndërmarrjen. Duhet me pas një plan të qëndrueshmërisë financiare për vitin e ardhshëm, rritjen e buxhetit për logjistikë dhe siguri në punë. Është shqetësuese që për këpucë dhe veshmbathje janë vetëm 448.00€. Shqetësuese është edhe se si ndërmarrje nuk ka asete por i ka të huazuara prej Ekoregjionit. Ose me marrë një vendim që ato paisje me kalu në ndërmarrjen komunale pasi ne jemi aksionar, ose me bo një plan të investimeve si kuvend dhe me i nda disa mjete që me i pas ato paisjet e veta por jo të huazuara. Në raport nuk mjafton vetëm me thënë: pastrami i rregullt apo aksione të posaqme. Duhet me ditë saktë cilat janë punët, sa kilometra, sa punë janë në atë pjesë.

Kryesuesi - rekomandimet do ti kemi parasysh por meqenëse është viti i pare që është duke operu dhe vërtetë ka pas disa mjete të huazuara prej ndërmarrjes Ekoregjioni. Në moment kur ndërmarrja faktorizohet dhe fuqizohet me kapacitetet e veta, ka me fillu edhe procedura tjetër për ti marrë asetet që ne i kemi te Ekoregjioni.

Nexhat Ramadani - për mua raporti si material që na ka ardhë, më shumë e konsideroj si një raport të ndërmarrjes se sa një raport të komisionit të aksionarëve. Ajo që e the ti kryesues me fjalë, unë e pashë që ai ka qenë raport sepse raporti i komisionit të aksionarëve duhet të përmbajë aktivitetet e komisionit por mund të përmendet edhe raporti financiar pak. Ky është për ne dhe është dasht në letër ta kemi këtë. Ne e vlerësojmë dhe e dime që ndërmarrja është e re, ka vështirësi dhe urojmë që sa ma shpejtë të krjojë bazamentin. Kësaj radhe ne po e tejkalojmë përndryshe ne kemi me miratu raportin e komisionit të aksionarëve.

Urim Suka - një çështje që nuk u tha, unë nuk e kam të qartë. Pagesa për shërbimet e kryera sipas kontratës në shtëpi nga komuna e Suharekës. çfarë kuptimi ka kontrata në shtëpi?

Bujar Kuçi - si kryeshef ekzekutiv i ndërmarrjes NPL "Eko Theranda" jep sqarime dhe thotë që kontrata në shtëpi është kur dy autoritete publike lidhin marrëveshje në mes vete për shërbime të cilat ka nevojë njëri nga autoritetet publike për ti kryer këto shërbime. Kjo kontratë nuk i nënshtrohet ligjit të prokurimit publik dhe për këtë quhet si kontratë në shtëpi.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 7.

Unanimisht Miratohet pika 7

Sanie Kuçi Rexhepaj - qytetarë që janë duke na dëgju janë tensionun që asnjëri prej mikrofonave tanë nuk janë duke bërë, as ai në foltore kur dola unë dhe dhashë sqarime tjera nuk ka funksionu. Si kritikë që herën tjetër paraprakisht me u kontrollu secili mikrofon a po punon apo jo.

Pika 8. Informatë për administrimin e buxhetit të komunës së Suharekës për periudhën janar-qershor 2026;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - te lista e investimeve kapitale duket që shpenzimet janë jashtëzakonisht të vogla. Përqindja e realizimit të buxhetit është jashtëzakonisht e vogël dhe kur këto shifra janë të vogla rezulton që nuk janë realizu projekte në teren. Për investimet kapitale kemi vetëm 22.08% që është bërë shpenzim dhe prej tyre afërsisht 240,000.00€ janë që janë marrë prej përmbaruesve. Kur flasim për 6 mujorin i bie që është kryer gjysma e vitit. Edhe kur është kryer gjysma e vitit dhe janë 22 % e realizimit, kjo len shumë për me dëshirë. Çështjet që i kemi ngrit vazhdimisht, kur ti e koncentron shpenzimin vetëm në tre mujorin e fundit, mundësia e keqpërdorimeve, mundësia e mosrealizimit të duhur të projekteve, i cilësisë, është e madhe. Kjo praktikë juve po ju ndodh vazhdimisht përkundër kritikave që ne i kemi dhënë. Te ndërtimi i kanalizimeve janë shpenzu 13,142.00€ sipas raportit dhe kjo nënkupton që ju keni bërë kontratë për kanalizim nëse i keni hargju paratë. Meqenëse keni bërë kontratë, atëherë pse nuk po gjejnë zgjidhje kanalizimet te lagjja "Zekolli" dhe "Te shelqet" në Bllacë? Kur kam bërë pyetje atëherë ju keni thenë që kemi m'i kry sapo ta bëjmë kontratën. Gjithëashtu problem tjetër te kanalizimet është në fshatin Javor që aty unë moti e kam ngrit shqetësimin e që aty gati nuk është bërë kurrë. Pas asaj ju e keni bërë një kanalizim të vogël në një pjesë të lagjes por pjesa kryesore e fshatit prap vazhdon me pas mungesë të kanalizimit. Ju lus ta keni parasysh që me kontratën, nëse e keni, të intervenoni sa ma shpejtë. Te rikonstruimi i shkollave janë bërë shpenzim 53,000.00€ dhe dua ta di në cilat shkolla është investu. Pashë te zyra e Kryetarit disa pozicione por e krahasova me raportin më herët por këto çështje nuk kanë qenë. Por këto ishin edhe nëpër drejtoritë tjera. Ndoshta e ka bazën në rregull por kërkoj sqarime nga ju. P.sh. Shtesa e performances te zyra e Kryetarit 12,870.00€. Shtesa për vëllimin e punës ku janë shpenzu 961.00€ dhe kujdestaria, puna jasht orarit të punës janë shpenzu 1,165.00 te zyra e Kryetarit.

Erëza Ramadani - tek pjesa e kontratës për kanalizim dhe kemi fillu me iniciimin e procedurës ku DSHPE i ka sjell letrat. Pjesa e pagesave është prej borgjeve të mëhershme që kanë qenë punime të mëhershme të papaguara. Te pjesa e rikonstruimit të shkollave, ne e dime që është punuar në shkollën e mesme gjimnazi "Jeta e Re". Sa i përket shtesave të performances është një ndryshim që është bërë te lista e pagave, u rrit koeficienti te shtesat e përfomacës. Te shtesat e vëllimit të punës janë zyrtar që janë të angazhuar me punë shtesë për shkak të vëllimit të madh të punës dhe ligjërisht kemi të drejtë me dhënë shtesë ku 20% lidhet kontrata dhe marrin shtesë. Pjesa e kujdestarisë janë zyrtarët që punojnë jasht orarit të punës dhe paguhet për këtë pjesë e cila është e rregulluar me ligj.

Urim Suka - ne shpeshherë kemi pa promovime të Kryetarit duke thënë: për mua s'ka orar, unë punoj jasht orarit. Po punohet jasht orarit por edhe kur po punohet jasht orarit, po paguhet. Nuk ka shqetësim, kush do që punon le të paguhet por të paktën kur po promovohet le të dihet që edhe po paguhet.

Liridon Fandaj - unë e kam bërë një analizë të shpenzimeve ku gjatë 6 mujorit komuna ka shpenzu 11,270,557.97€. Struktura e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike ndahet si vijon: paga dhe meditje 7,760,903.87€, mallra dhe shërbime 1,468,060.93€, shpenzime komunale 244,546.00€, transfer dhe subvencione 604,722.51€ dhe investime kapitale 1,192,323.75€. Nëse e kthejmë në përqindje, 68.86 % e buxhetit ka shku për paga dhe meditje. Vetëm 10.85% e buxhetit është shpenzu për projekte kapitale. Kjo i bie që ekzekutivi për këtë 6 mujor veq ka qenë me shpërnda paga dhe meditje por jo ndonjë investim Kapital për qytetarë. Vlen të theksohet se Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit ka zero investime prej 120,000.00 të alokuara. Nga fondi 10 Grantit qeveritar për kapitale janë alokuar

4,081,487.00€, janë shpenzuar 849,660.57€. 3.2 milion euro për këtë 6 mujor janë blloku dhe është shqetësuese sepse nëse edhe granti qeveritar nuk shpenzohet për këto 6 muaj mandej shkojnë suficit. Goditje tjetër buxhetore janë vendimet gjyqësore që arrijnë afërsisht 739,000.00€. Po ashtu performacë e dobët e inkasimit të tatimit në pronë. Realizimi i tatimit në prone dhe tokë është 50.34 % e planifikimit krahasuar me periudhën e vitit të kaluar ku inkasimi është 24.55 më pak se kjo periudhë. Shpenzimet 61,530.57€ për shërbime të veçanta konsulent dhe 91,800.00€ për shpenzime për anëtarësim. Çka nënkuptojmë me këto shpenzime? Për akomodime në udhëtime jashtë vendit janë shpenzuar 13,874.43€, ku një pjesë është para e gjepit 848.20€. Janë shpenzuar 29,311.75 për furnizim me ushqim dhe pije pa përfshirë drekat zyrtare. Kërkoj sqarime për këto.

Erëza Ramadani - sa i përket tatimit në prone të të hyrave është e vërtetë që ka ramje krahasuar me vitin e kaluar. E kemi cek edhe seancat e kaluara që ne kemi pas problem shumë me tatimin në pronë prej ministrit. Fillimisht me vonimin e faturave që na i kanë liru në sistem, pastaj i kanë sjell me vonesë për me i shpërnda tek posta, afërsisht me 15 ose 17 qershor janë dorëzuar në postë. Shumica e qytetarëve nuk janë në dijeni që munden me i nxjerr ato edhe online. Gjithëashtu edhe faturat kur na kanë ardhë, kanë qenë me probleme të shumta dhe është dasht me ndërhy çdo të dytën faturë. Sa i përket shpenzimeve konsulente është e vërtetë shifra 61,000.00. Janë shërbime që i kryejnë zyrtarët komunal që paguhen nëpër komisione për projektet që i realizojnë dhe secili komision paguhet 100€ nëse nuk gaboj. Unë e kam edhe faturën se ku shkojnë ato shërbime. Është kontrata për hartimin dhe renovimin e projekteve komunale, zyrtarët që i bëjnë edhe paguhen. Shpenzimet e anëtarësimit janë anëtarësimet që i paguajmë nëpër asociacione të ndryshme që marrin pjesë. Të akomodimit janë udhëtimet e zyrtarëve që dalin jashtë vendit. Furnizimet me pije dhe ushqim janë ushqimet që i marrim në byfe dhe furnizimet tjera që marrin zyrtarët që nuk kanë qasje direkte në byfe, shkojnë e marrin ushqim dhe pije në zyret e tyre me vendim të Kryetarit.

Liridon Fandaj - si Drejtori e Ekonomisë dhe Financave duhet me pas pak prioritet pjesën e granteve qeveritare. Është një planifikim por shumicën e pagesave duhet mu mundu me qu edhe prej grantit qeveritar por jo prej të hyrave vetanake. Në këtë 6 mujor që kemi hy, është mirë që investimet kapitale me i pas parasysh.

Astrit Salihu - te pjesa e shpenzimeve kapital për periudhën janar, te Drejtoria e Kulturës është ndërtimi i minifushave të futbollit dhe janë alokuar 50,000.00€, janë shpenzuar 50,000.00€.

Erëza Ramadani - nuk ka fillu ende procedura. Është gabim teknik që e ka bërë ZKF-ja gjatë përpilimit.

Pika 9. Informatë për aktivitetet e KKS-së për periudhën janar-qershor 2026;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - për mua por besoj edhe prej secilit prej juve siguria duhet të jetë tema kryesore prej të cilës ne nisemi. Andaj si temë shumë rëndësishme unë mendoj që meriton trajtimin maksimal të secilit prej neve. Unë jam mundu me lexu raportin dhe për fatin e keq më duket një lloj shablloni dhe një lloj trajtimi jo serioz që ja bëni. Nga viti në vit raporti i njejtë, temat e njejtë dhe shpeshherë edhe fjalët e njejtë, dhe më vjen çudi pse e keni këtë nivel të papërgjegjshësisë dhe pse në KKS nuk trajtoni edhe tema tjera dhe mbi bazën e asaj me marrë vendime në teren për me rrit sigurinë e qytetarëve dhe mirëqenien e tyre. Për më tepër edhe gabime drejtshkrimore. Në këtë raport ndër tjera është trajtu edhe problemi i qenëve endacak ku madje keni konstatu që problemi i qenëve endacak është problem madhor. Së fundi ka pas një rast në Grekoc ku është sulmu një qytetar dhe ka pas lëndime të rënda. Për veq që keni konstatu problem madhor, deri në këto momente nuk keni marrë asnjë veprim për trajtimin e qenëve endacak, flas për periudhën 6 mujore. Kam informatë që ju dje keni nënshkru një marrëveshje bashkëfinancimi me një shoqatë për trajtimin e qenëve endacak. A është ligjore lidhja e kësaj marrëveshje? Mjetet që do të shpenzohen, a do ti nënshtrohen procedurës së tenderimit apo sipas marrëveshjes keni me i pagu mjetet kësaj shoqate për shërbimet që ajo kryen pa tenderim fare? Ka shumë probleme që ndikojnë te siguria qytetare, duke fillu nga gjendja e rrugëve ku në shumë vendbanime kemi dëmtime të rrugëve për shkak edhe të cilësisë së dobët të punimeve dhe çdo vit duhet me pas një kontratë për mirëmbajtje. Mendoj që duhet me marrë seriozisht këtë çështje. Ndriçimet publike-sinjalizimet në rrugë. Ndriçimet publike që ju i keni vendos shumë herë janë jo funksionale dhe e rrisin pasigurinë e qytetarëve. Sinjalizimi në rrugë është jashtëzakonisht me rëndësi dhe aty ku mungojnë, aty ku shlyhen, aty ku ka punime duhet të intervenohet me kohë. E patëm stuhinë që ishte këto ditë dhe unë me sa di paralajmërohen komunat nga institute atje para se me ndodh stuhia. Është mirë komuna me i njoftu kryetarët e fshatrave, me sensibilizimi në faqe. Pra është mirë sensibilizimi me u bë pak më me kohë

që secili me ditë dhe me parandalu. Në shumë vendbanime kemi mungesë të trotuareve ku fëmijët tanë rrezikohen çdo ditë prej lëvizjes së makinave. Objektet me rrezikshmëri. Të gjitha këto duhet me i identifikuar si komunë, me i diskutu, me fol me kryetarët e fshatrave se ku janë këto probleme që potencialisht janë rrezik për qytetarët dhe komuna me i pas në fokus, me intervenu para se me ndodh ndonjë fatkeqësi që e rrezikon jetën e qytetarëve. Siguria në punë. E pamë çka ndodhi në Prishtinë. Unë lus ta kenë vëmendjen edhe inspektorët e ndërtimit që të jenë sa ma shumë në teren, të marrim masat e nevojshme para se me ndodh fatkeqësia. Andaj këto tema është mirë të trajtohen edhe në këshill ku jeni dhe ku do tjetër dhe të merren masa që të rritet siguria e njerëzve. Këtu në raport te pjesa e arsimit shkruan që kaq maturantë janë këtë vit por s'është relevante. Ka shumë tema tjera edhe për sigurinë në arsim, si daljet emergjente, rrethojat e shkollave, a ka rrezikshmëri trafa e rrymës në Bllacë e cila është në oborr të shkollës për të cilën sa kërkesa i kam bërë dhe askush s'ka ardhë me hek. Ju lus që temën e çështjes së sigurisë ta ngrisim në një nivel tjetër me qëllim parandalimi të shumë situatave.

Armend Krasniqi - çështja me qentë endacak në Kosovë, jo vetëm në Suharekë, është kaotike. Mendoj që duhet të merren shumë më shumë edhe institucionet shtetërore dhe komunale që ta bëjnë një zgjidhje më të mirë në këtë drejtim. Në ardhjen në drejtori kam parë që ekziston një kontratë deri në muajin prill. Me marrjen e informacionit të terenit kemi parë që diku 2000 qenë sillen në komunën e Suharekës. Ne kemi kontaktuar me një veterinar ku një organizatë ka lidhur një kontratë, e cila e ka bërë sterilizimin e 46 gushtave për mos me u shtu ato. Dje kemi lidhur një kontratë tjetër e cila kontratë ka për qëllim 150 qenë me i trajtu. Sa është ligjore besoj që zyra e Kryetarit e ka konstatuar. Kontrata është lidh me një fondacin të huaj ku 51 % të vlerës e japin ata dhe 49% e jep komuna e Suharekës.

Kryesuesi - drejtor e cekët që janë rreth 2000 qenë dhe trajtimi është për 150, mos është pak?

Armend Krasniqi - jo, nuk janë krejt të patrajtuar. Komuna e Suharekës vazhdimisht ka pas kontrata ku është marrë me sterilizim, kastrim, ngjitje të GPS të qenëve ku në rast të ndonjë sulmi e ka identifikuar se ku është ai qen.

Urim Suka - nuk mora përgjigje për pyetjet. Ju e adresuat te zyra e Kryetarit dhe e konstatuat gjendjen. Për kontratën që e keni lidh dje, a është ligjore dhe mjetet a kanë me u shpenzu përmes procedurës së tenderimit apo jo?

Armend Krasniqi - kontratën të cilën e ka lidh komuna me një organizatë është plotësisht ligjore sepse edhe dy komuna tjera e kanë ushtruar. Më 51 % nëse merr ndonjë organizatë e huaj participim me komunën, atëherë ligji e konstaton që është ligjore.

Avni Bytyqi - unë tash mora informacion që ka nënshkru një marrëveshje të tillë Kryetari i komunës. Nuk e kam pa atë marrëveshje dhe nuk kam përgjigje.

Urim Suka - ju lus që për mbledhjen e ardhshme të ma ktheni një përgjigje për këtë çështje, çoftë edhe me shkrim.

Pika 10. Raporti i Drejtorisë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër për menaxhimin e pronave për periudhën janar-qershor 2026;

Kryesuesi - i njofton me pikën dhe hap debatin.

Mensur Selimaj - ky raport është 6 mujor prej ditës që e kam marrë detyrën deri në qershor. Këto prona janë trajtu prej drejtorisë tonë dhe i keni secili në dokumenta që ju ka dërgu zyra ligjore.

Sanie Kuçi Rexhepaj - unë sa e di Drejtoria e Pronës e ka obligim ligjor me raportu në kuvend rreth kontratave që janë nënshkru mirëpo edhe për zbatimin e kontratave të tjera përtej asaj çka është zhvillu në këtë 6 mujor. A e ka për obligim me raportu vetëm për kontratat që janë nënshkru në këtë 6 mujor apo edhe rreth zbatimit të kontratave të tjera. Kërkoj sqarim ligjor.

Kryesuesi - pikën që po e diskutojmë ne, kemi të bëjmë vetëm me përditësimin e të dhënave për periudhën 6 mujore.

Avni Bytyqi - nëse i referoheni nenit 22 të ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronave, decidivisht e thotë që mbikqyrjen e kontratave. Po ashtu neni 27 i rregullores për zbatimin e procedurave të ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronave decidivisht e thotë që bëhet mbikqyrja e të gjitha kontratave dhe raportohet çdo 6 muaj në kuvend.

Sanie Kuçi Rexhepaj - ky raport ndoshta është raport i punës së drejtorit por nuk është raport që e kryen detyrën ligjore të Drejtorisë së pronës. Kërkoj nga Drejtoria e Pronës që të paktën mbledhjen e ardhshme të na sjell një raport rreth zbatimit të të gjitha kontratave që i ka nën menaxhim.

Urim Suka - unë sa e di kjo është kompetencë e Kryetarit të komunës dhe Kryetari i komunës obligohet me raportu çdo 6 muaj për të gjitha kontratat. Sa i përket drejtorisë në fjalë, kjo është detyrë që ti e ke në

baza ditore.Ka shumë ndërtime pa leje,uzurpator,ka shumë kontrata që komuna i ka lidh dhe nuk po zbatohen,e shumë çështje.Ajo që duhet të bësh ti në baza ditore,duhet ti marrësh ato,ti trajtosh,të bësh një plan veprimi dhe me fillu me punu për secilën kontratë dhe me fillu me vendos në një rend zgjidhjen e secilës dhe në fund çdo 6 muaj vjen raporti.Ky raport s'ka ardhë kurrë.Vitin e kaluar ka ardhë një dhe tash i dyti.Nëse ju nuk raportoni ato veq kanë me vazhdu m'u grumbullu.Andaj çdo 6 muaj duhet me raportu me synimin me i zgjidh.

Pika 11.

Flamur Bytyqi - kjo nismë vjen si rezultat i bashkëluftëtarëve të UÇK të fshatit Savrovë.Njëkohësisht është mbështetur me nënshkrimin e konfirmuar edhe prej kryetarit të fshatit.Lokacioni i cili kërkohet për ndërtimin e kësaj pllakate është me nr. Parcelës P72116037001701.Këto dokumente që i kam unë,i kanë edhe shefat e grupeve të cilat janë përcjell,jo prej meje.Andaj nëse dikush nuk e njeh,komandant Shaban Gashi ka qenë udhëheqës i kompanisë së dytë,batalionit të dytë të Brigdës 123 i cili ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm gjatë luftës së UÇK-së.Për veprën dhe përkushtimin e tij të palodhshëm ndaj atëdheut,ai është nderuar pas kalimit në amshim nën urdhërin e lartë Luftëtar i lirisë Adem Jashari nga presidentja e Kosovës Vjosa Osmani.Andaj kolegë ju ftoj që këtij propozimi ti japim mbështetje pa dallim partie.

Kryesuesi - personalisht e kam njohur Shabanin,kemi qenë bashkë.Ka dhënë kontribut ai dhe shumë luftëtar të tjerë.Në komunën tonë i kemi mbi 1600 veteranë,kemi dëshmor,kemi invalid,kam edhe vëllaun tim i cili është invalid i luftës.E respektoj kërkesën tuaj por unë ju sugjeroj që ti ndjekni procedurat përmes zyrës së kadastrës,t'ju ndahet parcella dhe lokacioni të caktohet si duhet.Unë do ta vendos në votim por le të dorëzohet në mënyrë institucionale dhe vjen si pikë e rregullt dhe e votojmë.

Besa Kuçi - sa i përket kësaj pike,unë jam pro me hy si pikë e rendit të ditës por vërtetë nuk u ditke ku është materiali,kush kënd e ka infromu.Është shumë e lehtë me na bë forward atë material që e ke sepse të gjithë emailat i kemi dhe këtu vota është e lirë.

Avni Bytyqi - besoj që askush nuk është kundër kësaj çështje që e ngriti Flamuri por mendoj që ndoshta është mirë ti ndjekim rrugët ligjore dhe procedurale.Komuna jonë e ka të miratuar PZHK dhe HZK-në dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim ka për obligim që ta shikojë në Hartën Zonale dhe çka është e planifikuar në kuadër të asaj parcelle. Dhe nëse në kuadër të asaj parcelle është e planifikuar çështja e varrezave,besoj që nuk ka nevojë të merret vendim në asamble për arsye se DUPM jep pëlqimin për ndërtimin e atij lapidari pa ndonjë pengesë ligjore.Ndërsa nëse nuk është e paraparë me HZK atëherë diskutojmë mundësinë dhe e sjellim në asamble për ndarjen e lokacionit.

Flamur Bytyqi - me pas ditë që bëhet çështje e diskutimeve,nuk e kisha sjell.Të gjithë kanë qenë të njoftuar për këtë çështje.

Kryesuesi - unë nuk kam qenë i njoftuar.

Flamur Bytyqi - Aziz ke qenë i njoftuar,të gjithë shefat e grupeve.Kryetari ka premtu që me u vendos kjo pllakatë.Unë si asambleist e kam për obligim këtë kërkesë me sjell këtu dhe nuk jam duke bë politikë me figura,sidomos me këto raste.

Aziz Bytyqi - unë dje e kam marrë një telefonatë për këtë çështje dhe mi ka dërgu ato materiale dhe më ka tregu që ti ke me inicu.Të vetmin zotim që e kam marrë para tij është:nesër do ta diskutoj me grupin dhe do ta shofim se a është kompetencë e kuvendit në aspektin ligjor.Ne e kemi diskutu këtë çështje që nuk ka nevojë me shku përmes kuvendit.E bën një kërkesë në DUMP,e merr pëlqimin dhe vendoset pllaka.Respekt për kontributin e z.Gashi dhe respekt për propozimin tënd.

Dardan Berisha - unë mendoj që ne si asambleista duhet me pas kujdes në këto tema sepse nuk duhet me ra në lajthitje të individave të caktuar.Unë si shef i grupit nuk jam i informuar.Çdo herë po e diskutojmë edhe anën ligjore dhe ne nuk mund të ndajmë parcellë pa ardhë prej drejtorisë sepse është e jashtëligjshme.

Flamur Bytyqi - realisht është dasht me rregullu ndryshe si komunë që me pas një fotografi për secilin veteran.Por për deri sa u toleru kjo çështje,normal që ke me pas kërkesa të tilla.Mua më ka ardhë si kërkesë dhe unë si asambleist e kam obligim me sjell këtu.

Kryesuesi - e hedh në votim që kjo pikë të tërhiqet dhe të shkon në procedurë të rregullt atje.

14 për,tërhiqet pika shitesë

Pika 12.Pyetje dhe përgjigje;

Vlora Kryeziu - në mbledhjen e kaluar kam parashtruar një pyetje në lidhje me projektin për ndërtimin e zonave infrastrukturore smart për të cilën nuk kam marrë përgjigje. Drejtori i DUMP më ka thënë që përgjigjen do ta marrë asamblenë e ardhshme, andaj dua ta dëgjoj përgjigjen.

Visar Kuçi - Te pjesa e smartit, tani ato pjesë të hyrje daljet, ekranet sinjalizuese në këtë fazë vetëm janë duke u lidh. Është një databazë për të dhënat ose njoftimet e komunës dhe kjo pjesë ka hy te smarti. Janë ato shtylla që janë vendos te stacioni i policisë, te sheshi „Brigata 123“, te sheshi „Fadil Vata“ dhe te rrethi zona industriale. Kemi me kalu edhe në pjesë të sinjalizimit të rrugëve në kuadër të digjitalizimit. Unë ndoshta se njoh mirë këtë pjesë por vazhdimisht konsultohemi me ekspertë të fushës. Na ke bërë edhe një kërkesë të cilën e ke bërë përmes zyrës së Kryetarit dhe përgjigjen do ta kthejmë.

Vlora Kryeziu - unë edhe asamblenë e kaluar kam thënë dhe prap them që do të mbetet interesimi im kryesor nëse ky projekt do të ndikojë drejtpërdrejtë në përmirësimin e qasjes dhe sigurisë së qytetarëve përfshirë posaqërisht personat me aftësi të kufizuara.

Qëndrim Elshani - kemi kërkesë të shumë qytetarëve, banorëve të Suharekës që banojnë në banesa kolektive, në veqanti për banesën përballë shtëpisë së kulturës. Secila familje që banon aty paguan tatim në pronë mirëpo gjatë fatkeqësisë së fundit që ndodhi në qytetin tonë, kanë rënë llastrat prej kulmit në tokë dhe janë bërë disa dëme tjera. Si është mundësia që komuna e Suharekës me i sanu këto probleme sepse është vërtetë shqetësim me vend?

Amir Hoxha - me vendim të Kryetarit të komunës janë bërë tre komisione për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë që karakterizuan me erërat e fundit. Puna jonë nuk dallon prej komisioneve të kaluara kur fondet emergjente kanë qenë në komunë. Ne kemi formularë të gatshëm prej AME-së ku në atë formular duhet me i vendos pikat dhe sipas atij formulari me vlerësu dëmin. Gjatë vlerësimit që janë bërë, unë e kam pa që shumica e objekteve nuk kanë as legalizim fare dhe jo vetëm leje ndërtimore. Ne si DSHPE ia dorëzojmë inxhinierëve dhe ata inxhinierë si fillim pyesin a ka legalizim. Pastaj kur i shofim dëmet fizikisht, ata i vlerësojnë në aspektin inxhinierik. Pikat që jemi të detyruar me i vendos në formular, neve kanë me na karakterizu me përgjigje kryesisht negative.

Sanie Kuçi Rexhepaj - një shqetësim i qytetarëve tonë si në fshatra ashtu edhe në qytet është ndriçimi publik. Seancat e kaluara e kemi ngrit si shqetësim dhe nga drejtoria përkatëse na është thënë që janë në fazë të ndërprejes së kontratës. E kemi kërku një raport të investimeve që janë bërë ku është investu dhe ku nuk ka arrit m'u investu me ndriçim publik dhe prap po kërkoj raport të detajuar të dy kontratave që kanë qenë. Kanë qenë dy menaxher të kontratave. Me na raportu se çka është punu në secilin fshat, cili fshat është përfundu, cili fshat ka mbet pjesërisht me ndriçim publik. Siq kam informacion komuna ka nënshkru dy kontrata me vlerë rreth 2.5 milion euro në ndriçim dhe mbi 50% e vendbanimeve janë pa ndriçim funksional dhe me probleme. Duke pas parasysh që na ke thënë që kontrata është ndërpre, çka ndodh me garancionin për shkak se ato kontrata kanë qenë me afat 10 vjeçar dhe me garancion 10 vjeçar? Çka ndodh me garancionin dhe kush është duke u marrë me këtë çështje?

Amir Hoxha - kontrata ka përfundu me 70% për shkak se ne nuk kemi vazhdu me kontratën me trupat ndriçues të objekteve të brendshme sepse nuk kemi pas nevojë dhe ka qenë sasi e lartë. Kjo kontratë në paramasë ka qenë në emër të efijencës dhe në efijencë hyn vetëm trupat ndriçues dhe jo stabilimente tjera që i karakterizon një ndriçim publik të qëndrueshëm. Ndërsa për trupat ndriçues që hyjnë në efijencë, poqet kanë 10 vite garancion mirëpo ai nuk ndizet si poq edhe pse ka garancion dhe ai po shkon duke u hargju për shkak se ne kemi problem me pjesën tjetër, sepse komuna nuk e ka pas parasysh që ne kemi një ndriçim jostabil për shkak të paisjeve tjera dhe jo te poqet ndriçues. Përveq që ka qenë instalimi i amortizuar ka pas edhe dëme tjera prej erërave, zjarreve të ndryshme, intervenimeve të KEDS-it. Drejtori tutje jep sqarime dhe thotë se kemi me arrit me rehabilitu gjithë çështjen e ndriçimit publik.

Sanie Kuçi Rexhepaj - drejtor të kuptoj por kush është përgjegjës sipas jush për krejt këtë situatë ? për shkak se ti po thua që këto dëmet aktuale sipas juve nuk paskan kosto shumë të madhe mirëpo janë shpenzu viteve të fundit rreth 2.5 milion euro dhe kostoja është e madhe.

Amir Hoxha - sasi të janë aty. Është paramasë në emër të efijencës. Unë nuk kam qenë pjesë e hartimit të gjendjes së mëhershme dhe pse s'kam qenë unë nuk do të thotë që komuna ka pas faj sepse këta me siguri kanë mendu me pas efijencë, tek ndriçimi me pas sa ma shumë ndriçues në mënyrë që ne me pagu kosto mujore më të lirë te KEDS.

Sanie Kuçi Rexhepaj - ndoshta këta kanë mendu më mirë por mendimi joprofesional i ka kushtu komunës 2.5 milion euro dhe dikush duhet me dhënë përgjegjësi në këto çështje. Kush jep përgjegjësi në këtë çështje dhe çka jeni tu marrë hapa konkretisht ju si Drejtor i DSHPE në ndriçim?

Amir Hoxha - faj ka që ne nuk e kemi një kontratë të lidhur më herët që veq e mban në këmbë këtë ndriçim. Për që janë investu 2 milion euro, paisjet janë aty dhe ka raport të menaxherit të kontratës se ku janë shpërnda mirëpo ka mungu një kontratë tjetër për mirëmbajtje që ne e kishim pas atë ndriçues dhe e kishim pas aktiv. Nuk ka qenë një ekspertë që kësaj i duhet plus edhe një kontratë. Drejtori tutje jep sqarime.

Visar Kuçi - si rrjet ndriçimi në raport i kemi 134 km ku ka rrejt ndriçim.

Sanie Kuçi Rexhepaj - mbledhjen e kaluar unë kërkoja sqarim nga Drejtoria për rregulloren e bonus zonimit mirëpo mbledhjen e kaluar drejtori nuk ishte në disponim me dhënë përgjigje. Në pikën që u diskutu për raportin e PZH-së dhe HZK-së, u përmend pak bonus zonimi dhe drejtori tha që kur ka ardhë vendimi i ministrisë nuk ka pas të bëj kjo çështje pse është kërku me u shfuqizu rregullorja e bonus zonimit për shkak të mos raportimit të PZH-së dhe HZK-së. Si sqarim po e them që rregullorja për bonus zonim nuk është obligative por sipas mundësisë qysh do që e sheh të arsyeshme komuna e Suharekës dhe të arsyeshme e sheh nëse raporton në suaza vjetore për zbatimin e HZK-së. Edhe në raport në pjesët kur keni fol për bonuset e zonimit është dasht të cekni: kemi shumë kërkesa të investitorëve të cilëve pjesë e parcelave janë të planiikuar me HZK për infrastrukturë ligjore. Komuna nuk ka buxhet të mjaftueshëm për me i shpronësu për zgjerimin e infrastrukturës. Në këtë rast e sheh të arsyeshme hartimin e rregullores për bonus zonim për shkak se bëhet këmbimi i pronës me metra katror ndërtim. Kjo është baza që ty të lejon me hartu rregulloren e bonus zonimit. Për këtë arsye ministria të ka thënë që nuk mundesh me hartu rregullore kur nuk e din sa po zbatohet HZK.

Labint Halitjaha - ne kemi pas një komision më herët për vërsimet që kanë qenë por ekzekutimet e pagesave a janë kryer? Çka ka ndodh me këtë punë dhe çka po ndodh me komisionin tjetër? A keni ndonjë marrëveshje që kanë me u pagu këto?

Amir Hoxha - erërat e fundit që ishin, ishte edhe kryetari i komisionit Kastrioti dhe ai personalisht më tha që komisioni ka qenë puna më e mirë dhe më e vlerësuar në nivel vendi atje mirëpo kompenzimet e dëmeve nuk janë bërë nga qeveria. Aty vendos qeveria kur i lëshon paratë.

Dafina Kolgeci - pyetje për Drejtorinë e Arsimit e cila lidhet me gjendjen e shkollës fillore në fshatin Vraniq. Siq e dini të gjithë kjo shkollë ka filluar të ndërtohet në korrik të vitit 2019 dhe punimet nuk kanë përfunduar ende. Shkolla e re është në oborr dhe në afërsi të afërt me shkollën e vjetër. Për deri sa ka punime, në oborrin e shkollës ka material ndërtimor, ka kablo të rrymës elektrike që janë për toke, ka puseta të hapura, ka llamarinat rrethuese të cilat përbëjnë kërcnim për vijueshmërinë e mësimin për nxënësit që janë aty. Ne e dimë që është projekt i ministrisë së Arsimit mirëpo nëse keni ndonjë informacion zyrtar ose komunikim ose përpjekje nga ana juaj me ministrinë për me ditë se kur do të përfundojnë punimet për shkollën? Në shtator nxënësit e shkollës së fshatit Vraniq a do ta fillojnë mësimin në shkollën e re?

Remzi Bajselmani - është shqetësim edhe i yni që sa vite, komunikojmë edhe me ministrinë. Kompetencë nuk kemi. Operatori që është duke i kryer punët ka thënë që në korrik përfundojnë punimet. Jemi në koordinim me shollën për me i transferu disa paisje, inventar në shkollën e re e cila është duke ndodh tani sepse ka kërku operatorin me liru shkollën e vjetër për me shemb. Ne kemi shpresë që do të përgaditet shkolla e re dhe do të hiqet objekti i vjetër i shkollës.

Dafina Kolgeci - dje e kam pa dhe punimet nuk janë përfundu. A kanë me mësu nxënësat me inventar të vjetër a ka me pas inventar të ri?

Remzi Bajselmani - ne e dimë që ka me ardhë inventari i ri mirëpo disa paisje që janë në zyrën e drejtorit dhe të sekretarit të shkollës, janë duke u bartë. Banka e karrige ka pak dhe do të kujdeset ministria por nëse nuk kujdeset ministria, komuna do të kujdeset për inventarin e ri të shkollës.

Urim Suka - kam pas ankesa prej qytetarëve që furnizimi me barna është i keq nëpër AMF dhe QMF dhe e dyta ka të bëj me pagesën e punëtorëve me karitas. Kam pas ankesa nga ta që nuk janë duke u paguar pagat e tyre për punën që po bëjnë. Dua ta di se a është bërë zgjidhje dhe cila është gjendja rreth pagës së punëtorëve me karitas? Në DSHPE në fshatin Javor rruga „Fejz Koliqi“ segment është e pashtuar dhe me dhënë probleme. Kryesia e fshatit e ka parapa me u shtrë për vitin 2027 mirëpo në planifikim të kornizës kjo rrugë është heq dhe është planifiku për vitin 2028. A ka mundësi që në planifikim tash në shtator kur të vjen, kjo rrugë me u bërë në vitin 2027 sepse problemet janë të mëdhaja? Në planin e punës së kuvendit në muajin gusht ka qenë gjithmonë pika për raportimin e Drejtorisë së Arsimit por nuk ka ndodh kurrë. Kam dëshirë që mbledhjen e ardhshme të asamblesë DKA-ja me sjell një raport për përfundimin e këtij viti shkollor dhe për përgaditjet që janë bërë për fillimin e vitit të ri shkollor, me theks te sukcesi i vitit shkollor dhe në krahasim me vitin paraprak, orët e humbura, mungesa e nxënësve, investimet në shkollë, siguria në shkollë, cilat aktivitete ka ndërmarrë

DKA-ja për rritjen e cilësisë në arsim,për zvogëlimin e orëve të humbura dhe për zvogëlimin e numrit të mungesave të nxënësve.

Kymete Bajraktari - ekziston problemi me barna mirëpo kjo është për shkak të listës esenciale që bëhet prej ministrisë së Shëndetësisë.Ata vazhdimisht nuk na furnizojnë dhe furnizimin e bëjnë me vonesë.Sa i përket karitasit përmbaruesi i ka marrë afërsisht 240,000.00€ mallra dhe shërbime në QKMF.Prej mallra dhe shërbime kanë qenë të planifikuara edhe pagat e karitasit për shkak se janë shërbime.Në muajin qershor e kemi bërë një pagesë dhe tash jemi duke shiku për me i bërë edhe për muajt tjerë që iu kemi mbetë borgj.

Amir Hoxha - ne kur i kemi bërë matjet e rrugëve,mjetet nuk kanë dalë për këtë vit me i krye dy rrugët dhe në planifikim ka qenë një rrugë tjetër që e ka sjell kryesia e fshatit dhe ne kur i kemi bërë matjet e kemi pas të pamundshme me shtrë edhe rrugën „Fejz Koliqi“.Unë kam insistu që të shtrohet rruga Fejz Koliqi sepse është shumë ma emergjente dhe jo tjetra por në fund ka ardhë Shemsiu me idenë që me shtrë rrugën tjetër,pra ata e kanë vendos si kryesi e fshatit.Pastaj ne si drejtori e kemi inicë procedurën 2 vjeqare që të shtrohet edhe rruga Fejz Koliqi.

Urim Suka - me sa unë e kuptova ajo rrugë do të shtrohet këtë vit dhe pagesa i bëhet në vitin 2027.

Amir Hoxha - po,ajo është kontraktë.

Urim Suka - Drejtoresha fajin e la te ministria.Unë me sa e di është edhe një buxhet që e ka komuna që i furnizon me barna.Çka po ndodh me ato?A është shfrytëzu ai buxhet?Me sa unë e di përmbaruesi të pyet ku do me ti marr mjetet.Pse po i merr bash këto ku njerëzit po punojnë dhe po mbesin pa paga dhe a ka mundësi me bërë zgjidhje?

Takimi përfundoi: 13:40

Procesmbajtësja: Dafina Haziraj

Kryesuesi i Kuvendit

Mr. ec Bexhet Kuçi